

KONTRATË SHITJE

E lidhur në _____, sot, ditën e _____, dt. _____._____ ndërmjet palëve :

- I. Shitës:** _____, i biri i _____ dhe _____, lindur më _____._____._____ në _____ dhe banues në _____, me adresë Rruga “_____”, Pall _____, Ap. _____, mbajtës i pasaportës me nr.cel. _____.
- II. Blerës:** _____, i biri i _____ dhe _____, lindur më _____._____._____ në _____ dhe banues në _____, me adresë Rruga “_____”, Pall _____, Ap. _____, mbajtës i pasaportës me nr. cel._____.

Palët me marrëveshje dhe me vullnetin e tyre të lirë, në përputhje me nenet e Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë,

VENDOSËN

të lidhin këtë kontratë me këto kushte

Neni 1

Objekti i shitjes, i kontratës

(Pershkruaj me detaje se cfare shisni).

Neni 2

Cmimi dhe mënyra e pagimit të tij

_____objekt i kontratës shitet kundrejt cmimit _____
(_____) lekë.

Pagesa do të kryhet më datë _____._____._____ në Cash ose ne Bankën _____
në llogarinë me nr._____.

Cdo ditë vonese në pagesë blerësi duhet të paguajë një kamatë-vonese ____ % të vlerës së cmimit të shitjes.

Neni 4

Pagesa te tjera

Blerësi merr përsipër të paguajë të gjitha detyrimet që rrjedhin nga kjo kontratë si dhe shpenzimet e tjera që rrjedhin nga blerja e sendit.

Neni 5

Te drejtat dhe detyrimet e shitësit

1. Shitësi është i detyruar të dorëzojë sendin në gjëndjen që është në momentin e lidhjes së kontratë .

2. Shitësi është i detyruar t'i dorëzojë blerësit të gjithë dokumentacionit që konfirmon të drejtën e pronësisë, apo te drejtat reale te prones dhe që janë të nevojshme për kalimin e saj pasi blerësi të ketë paguar çmimin e shitjes.

3. Shitësi ka të drejtë të kërkojë nga blerësi pagimin e cmimit në mënyrën dhe afatin e parashikuar në këtë kontratë.

4. Shitësi duhet të garantojë blerësin për gëzimin e qetë të sendit e të lirë nga çdo e drejtë përdorimi apo pronësie të personave të tretë. Shitësi është i detyruar të marrë pjesë në gjykim në mbështetje të blerësit nëse ai thirret prej tij, për ta garantuar ndaj pretendimeve të personave të tretë, mbi sendin objekt i kontratës. Në rast se blerësit i merret sendi dhe shitësi është në keqbesim, ai është i detyruar t'i kthejë cmimin e paguar atij si dhe shpërblimin e dëmit.

5. Shitësi është i detyruar të garantojë blerësin për cilësinë e sendit dhe mungesën e të metave.

Neni 6

Të drejtat dhe detyrimet e blerësit

1. Blerësi ka të drejtë të kërkojë dorëzimin e sendit dhe dokumentet që vërtetojnë pronësinë e shitësit mbi to, objekt kontrate nga shitësi nga e nesermja e hyrjes ne fuqi te kesaj kontrate.

2. Blerësi është i detyruar të marrë sendin në dorëzim, në afatin e parashikuar në këtë kontratë.

3. Blerësi është i detyruar të marrë sendin në dorëzim në vendin ku ndodhet ky send.

4. Blerësi detyrohet për pagimin e cmimit në afatin dhe mënyrën e parashikur në nenin 3 të kësaj kontrate.

5. Blerësi ka të drejtë të kundërshtojë të metat e sendit brenda një afati prej ____ vitesh.

Neni 7

Rastet e zgjidhjes së kontratës

1. Shitësi ka të drejtë të kërkojë zgjidhjen e kontratës në këto raste:
 - a) blerësi nuk paguan cmimin në afatin e caktuar;
 - b) blerësi nuk merr në dorëzim sendin as brenda afatit shtesë të përcaktuar nga shitësi;
 - c) blerësi refuzon të përmbushë detyrimet e tij brenda afatit kontraktor ose afatit shtesë .
2. Blerësi ka të drejtë të kërkojë zgjidhjen e kontratës në këto raste:
 - a) shitësi nuk dorëzon sendin brenda afatit të caktuar në kontratë;
 - b) shitësi nuk dorëzon sendin brenda afatit shtesë të përcaktuar nga ai vete;
 - c) shitësi refuzon të përmbushë detyrimet e tij brenda afatit kontraktor ose afatit shtesë.

Neni 8

Pasojat e zgjidhjes së kontratës

Në qoftë se kontrata zgjidhet palët kanë këto detyrime ndaj njera tjetrës:

1. Shitësi duhet t'i kthejë cmimin si dhe shpenzimet e tjera që ka bërë blerësi.
2. Blerësi duhet të dorëzojë sendin në gjëndje të pademtuar , në të kundërt do të paguajë dhe shpërblimin e dëmit të shkaktuar.

Neni 9

Rregulla të fundit

Kjo kontratë u hartua në gjuhën shqipe, në _____ kopje me fuqi të barabarta secila, nga një kopje të saj e marrin palët, dhe pasi iu lexua palëve u nënshkrua prej tyre me vullnetin e tyre të lirë sipas ligjit.

Kësaj kontrate i bashkangjiten dhe bëhen pjesë e saj: _____

Palët duhet të përmbushin detyrimet që rrjedhin nga kjo kontratë, në të kundërt për ta do të lindin pasojat e parashikuara nga Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë.

Në rast problemesh palët duhet t'ia komunikojnë ato menjëherë njera-tjetrës dhe në pamundësi të zgjidhjes së tyre me marrevëshje do t'i drejtohen Gjykatës së _____.

SHITËSI

BLERËSI